



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers

Për:	Xhafer Gashi , Kryetar i Komunës së Obiliqit Vlora Mjekiqi-Kabashi , Kryesuese e Kuvendit të Komunës Ramiz Lladrovi , Kryetar i Komunës së Glllogocit Milaim Hajdari , Kryesuesi i Kuvendit të Komunës Ljiljana Subaric , Kryetare e Komunës së Graçanicës Milan Dimitrijevic , Kryesues i Kuvendit të Komunës Vladan Bogdanoviq , Kryetar i Komunës së Kilokotit Milovan Bocic , Kryesues i Kuvendit të Komunës
Kopje:	Elbert Krasniqi , Ministër në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal Jeton Qela , ud. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Njësia për Administrimin e Dokumenteve, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Përmes:	Avni Zogjani , Zv. Ministër në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve Enis Spahiu , ud. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Nga:	Bora Duli , ud. Drejtoreshë e Departamentit Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Zyrtarët përgjegjës:	1. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor Razije Murtezaj, Zytare Ligjore, Departamenti Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve 2. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor Vehap Hashani, Zyrtar i Lartë Ligjor, Departamenti i Tatimit në Pronë, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve



Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë të akteve të Komunave	
Lloji i aktit:	Vendim	

Të nderuar Kryetar/e të Komunave,

Të nderuar Kryesues/e të Kuvendeve Komunale,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë, të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 04/2021, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-05 Për Vetëqeverisje Lokale, vendime komunale për miratimin e Komizës Afatmesme Buxhetore.

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (këtej e tutje referuar si "**Ministria**"), duke u bazuar vetëm në këndvështrimet që prekin fushëveprimin legjislativ të Ministrisë, si dhe pas shqyrtimit të përmbajtjes së akteve të bashkëngjitura në këtë shkresë, jep konstatimet ligjore bazuar në këndvështrimet e mëposhtme:

Andaj, lidhur me vendimet komunale, Ministria i ka njoftuar Komunitet në kontekst të nenit 5 të Ligjit Nr.08/L-224 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme të kontestuar në përputhshmëri me vendimin e Gjykatës Kushtetuese për gjatë periudhës sa ka qenë në fuqi masa e përkohshme pezulluese ndaj faljes së tatimit në pronë në kohëzgjatje deri më 30 nëntor 2023.

Ndërsa Gjykata Kushtetuese me datën 22.11.2023 ka vendosur që dispozitat ligjore për faljen e tatimit në pronë në vlerë prej 100 euro komunat mund të nxjerrin vendim për faljen e tatimit, që afati i mbetur pesëmbëdhjetë (15) ditë nga afati tridhjetë (30) ditë i përcaktuar me nenin 11/B (Shuma e faljes së tatimit në pronë për pronën e paluajtshme) të nenit 5 të Ligjit Nr.08/L-224 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, fillon të rrjedhë nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Aktgjykimi, si vijon:

Neni 11/C

Kufizimi

Falja tatimore e parashikuar me këtë kapitull zbatohet vetëm për vitin tatimor 2023 dhe nuk do të zbatohet për asnjë vit tjetër tatimor.

Neni 11/Ç

Administrimi

1. Zbatimi i këtij kapitulli mbetet përgjegjësi e çdo komune përgjegjëse për administrimin e procesit të tatimit në pronë për pronat e paluajtshme që ndodhen brenda territorit të komunës.

2. Ministria përgjegjëse për financa nxjerr vendime që mund të jenë të nevojshme për zbatimin e këtij kapitulli.

Në vijim, të kësaj, komunave iu konfirmohet ligjshmëria e vendimeve të nxjerra në lidhje me procedurat për faljen e tatimit në pronë për vitin 2023.

Ministria mbetet në dispozicion të Komunave në fjalë dhe/apo Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.
Me respekt!

****Interpretimi i dhënë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve përkitazi me këtë çështje mbështetet vetëm në këndvështrimet që prekin fushëveprimin legjislativ të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve****

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije
Ministry of Finance
Arkivo - Arhiva - Archive

1949-1/10000
25.09.23
PRISTINE/A



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Financave, Punës dhe Transferëve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transferu -
Ministry of Finance, Labour and Transfers*

Për:	Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Glllogcit
Kopje:	Milaim Hajdari, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës Elbert Krasniqi, Ministër në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal Jeton Qela, Zv. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Njësia për Administrimin e Dokumenteve, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Përmes:	Resul Makreshi, Zv. Ministër në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transferëve Enis Spahiu, Zv. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave, Punës dhe Transferëve
Nga:	Klit Shala, Zv. Drejtor i Departamentit Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transferëve
Zyrtarët përgjegjës:	Razije Murtezaj, Zyrtare Ligjore, Departamenti Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transferëve
Lënda:	Kërkesë për informata shtesë
Lloji i aktit:	Vendim



I nderuari Kryetar z. Lladrovci,
I nderuari Kryesues z. Hajdari,

Në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë, të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 04/2021, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-05 për Vetëqeverisje Lokale, aktin komunal si në vijim:

Vendimi 02 Nr.432/01-43977 për faljen e tatimit në pronë për vitin tatimor 2023
<i>I miratuar më datë 31.08.2023</i>
<i>I parashtruar për shqyrtim në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal më datë 01.09.2023</i>
<i>I dërguar për shqyrtim në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve më datë 13.09.2023</i>

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (këtej e tutje referuar si "Ministria"), pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të nënsipërm të Komunës së Gillogocit, jep konstatimet ligjore të mëposhtme:

1. Komuna e Gillogocit që është subjekt i shqyrtimit, ka synuar faljen e tatimit në pronë për vitin 2023.
2. Si pikë e parë, dhe për qëllime të këtij vlerësimi është me rëndësi të theksohet se Ministria ka njoftuar të gjitha komunat se lalja e tatimit në pronë si proces si dhe çdo vendim që është nxjerrë deri më tash është pezulluar, ashtu siç parashihet edhe në njoftimin zyrtar të Gjykatës Kushtetuese, si vijon:

Gjykata Kushtetuese ka marrë vendim për vendosjen e masës së përkohshme ndaj faljes së tatimit në pronë. Në njoftimin e dhëna nga vet Gjykata Kushtetuese, theksohet se: "Gjykata, njëzëri, ka vendosur që (I) kërkesa për vendosjen e masës së përkohshme lidhur me aktin e lartcekur të miratohet në kohëzgjatje deri më 30 nëntor 2023; dhe për pasojë (II) të pezullohet menjëherë zbatimi i nenit 5 të Ligjit Nr.08/L-224 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronë e Pajluajtshinë dhe zbatimi i vendimeve të nxjerra në bazë të këtij neni deri në afatin e lartcekur."

Ky pezullim i vendosur nga Gjykata Kushtetuese vlen vetëm për nenin 5 (KAPITULLI II/A Falja e Tatimit në Pronë për Vitin Tatimor 2023) të Ligjit Nr.08/L-224 për

Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, ndërsa dispozitat tjera të Ligjit Nr.08/L-224 vazhdojnë të zbatohen.

3. Duke marrë për bazë konstatimet e mësipërme, se neni 5 Falja e Tatimit në Pronë për Vitin Tatimor 2023 të Ligjit Nr.08/L-224 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për faljen e tatimit në pronë është pezulluar deri më 30 nëntor 2023 si dhe çdo vendim tashmë i nxjerrë nga komunal nuk mund të ekzekutohet deri në momentin e largimit të pezullimit, ndërsa komunat të cilat nuk kanë nxjerrë vendim por që kanë planifikuar të nxjerrin vendim duhet t'i pezullojnë procedurat dhe të presin deri në largimin e masës së përkohshme për ta bërë një gjë të tillë.
4. ***Si përfundim, do të vlen zbatimi i nenit 5 të Ligjit Nr.08/L-224 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme deri në afatën e lartcekur.***

Ministria mbetet në dispozicion të Komunës së Glllogocit dhe/apo Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.

Me respekt!

*****Interpretimi i dhënë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve përkitazi me këtë çështje mbështetet vetëm në këndvështrimet që prekin fushëveprimin legjislativ të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve*****



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit (Glllogoc)
Kuvendi i Komunës

Nr. 439/1 dt. 31.08.2023



Bazuar në nenin 11, 12 pika 12.1 dhe pika 12.2, nenit 14 pika 14.1 dhe nenit 40 të të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 34 pika 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Neni 5 Kapitulli II/A i Ligjit Nr. 08/L-224 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, Kuvendi i Komunës së Drenasit (Glllogoc) në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë: 31.08.2023, miratoi këtë:

V E N D I M

Për faljen e tatimit në pronë për vitin tatimor 2023

I.

Vendimi për për faljen e tatimit në pronë për vitin tatimor 2023, i cili rrjedhë nga Neni 5 Kapitulli II/A, Neni 11/B paragrafi 2 i Ligjit Nr. 08/L-224 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme.

II.

Qëllimi i këtij vendimi ka të bëjë me faljen e borgjit të tatimit në pronë për vitin 2023, i cili vendim prekë të gjithë tatimpaguesit që kanë detyrime të tatimit mbi pronën e paluajtshme për vitin tatimor 2023 ashtu së dhe është përcaktuar në Nenin 5 Kapitulli II/A, të Ligjit Nr. 08/L-224 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme.

III.

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa - Zyra e Tatimit në Pronë në bashkpunim me Ministrinë e Financave, Punës dhe Trasfereve - Departamentin e Tatimit në Pronë.

IV.

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është: Ligji Nr. 08/L-224 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme.

V.

Me këtë Vendim do të njoftohen organët kompetente të Komunës së Drenasit, Ministria e Financave, Punës dhe Trasfereve – Departamenti i Tatimit në Pronë.

VI.

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe publikimit të tij në shtetbuletin zyrtar të Republikës së Kosovës, si dhe ditë nga publikimi në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit ;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit



Kryetari i Kuvendit të Komunës

Mitran Hajdari